


-S.T.I.M.P.
-18.04.2023



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
KORÇË

Nr. 412/1016 Akti

Datë 29.03.2023

Datë regjistrimi 20.05.2022

SHPALLJE VENDIMI

Drejtuar: Njesia Administrative Maliq, Bashkia Bashkia Maliq.

Për shtetasen: Teuta Pine (ndruar emrin e mbiemrin nga Fluturie Agolli në Teuta Pine), e bija e Jani dhe Sofie, banuese në Maliq.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me trup gjykues të përbërë nga gjyqtar **Seladin Pysqyli**, asistuar nga sekretare Vitoria Hajçe, në gjykatë, sot më datë 29.03.2023, përfundoi gjykimin e çështjes civile me **nr. Vendimi 242**, me palë dhe objekt:

PADITËS: **Petro Agolli**, i biri i Dionis dhe Berta (ndruar emrin nga Bedri në Petro, atësia nga Ajdin në Dionis dhe amësia nga Behare në Berta), i datëlindjes 13.08.1958, banues në Maliq, përfaqësuar nga avokat Artur Brahimllari, antar i Dhomës Vendore të Avokatëve Korçë, i zgjedhur me prokurë të posacme nr.162 rep e 83 kol datë 02.03.2022, hartuar para noterit Aurel Qafzezi në qytetin e Korçës.

TË PADITUR: **1-Maria Pine** (ndruar emrin e mbiemrin nga Sose Agolli në Maria Pine), banuese në Maliq, në mungesë.

2-Lutfi Agolli, i biri i Faslliut, banues në Maliq, në mungesë.

3-Haxhire Agolli, e bija e Faslliut, banuese në Fshat-Maliq, në mungesë.

4-Pranvera Agolli, e bija e Faslliut, banuese në Maliq, në mungesë.

5-Teuta Pine (ndruar emrin e mbiemrin nga Fluturie Agolli në Teuta Pine), e bija e Jani dhe Sofie, e datëlindjes 20.08.1958, banues në Maliq, në mungesë.

6-Anila Kroj (Agolli), e bija e Përparim (Andrea) dhe Teuta (Fluturie), e datëlindjes 29.09.1983, banuese në Maliq, në mungesë.

7-Erik Pine, i biri i Përparim (Andrea) dhe Teuta (Fluturie), i datëlindjes 1985, banues në Maliq, në mungesë

8-Xhezmi Agolli, i biri i Faslliut, banues në Maliq, në mungesë.

9-Ilia Agolli, i biri i Faslliut, banues në Maliq, në mungesë.

Me objekt: Detyrimin e të paditurve të njohin paditësin pronar të një sipërfaqe trualli prej 128.65 m² nga i cili 93.65 m² ndërtesë, pjesë e pasurisë nr.2/89, e ndodhur në Maliq, Zona Kadastrale 2573, me sipërfaqe të përgjithshme 250 m², nga e cila 215 m² ndërtesë.

Baza ligjore: Nenet 31, 32/a të K.Pr.Civile dhe 163, 169-170 të K.Civil,

Në përfundim të gjykimit, pala paditëse kërkoi pranimin e padisë.

Të paditurit në mungesë.

Gjykata, pasi dëgjoi pretendimet e palëve dhe analizoi provat e marra në gjykim,

VENDOSI:

1-Pranimin e kërkesëpadisë me palë dhe objekt si më sipër.

Nr. 30 Prot

2-Detyrimin e të paditurve Maria Pine (Sose Agolli), Lutfi (Jani) Agolli, Haxhire Shkëmbi (Agolli), Pranvera Agolli, Teuta Pine, Anila Kroj (Agolli), Erik Pine, Xhezmi Agolli dhe Ilia Agolli, të njohin paditësin Petro Agolli pronar me parashkrim fitues pa titull të pasurisë truall me sipërfaqe 128.65 m² dhe ndërtesa mbi të me sipërfaqe ndërtimore 93.65 m² (shtëpi banimi), e ndodhur në Maliq, Zona Kadastrale 2573, pjesë e pasurisë 2/89, e cila në skicën e planvendosjes të hartuar nga eksperti Robert Papi pasqyrohet si pjesa "B", me ngjyrë jeshile, dhe kufizohet: Veri: pjesa "A" me sipërfaqe 121.35 m² në posedimin e të paditurve; Lindje: pasuria nr.2/148 e 4/10; Jugë: pasuria 2/148; dhe Perëndim: pasuria nr.2/148.

3-Urdhërohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës Drejtoria Vendore Korçë që, pasi vendimi të marrë formë të prerë, të bëjë regjistrimin e pasurisë me të dhënat si më sipër në emër të paditësit Petro Agolli.

4-Skica e planvendosjes e hartuar nga eksperti Robert Papi është pjesë përbërse e këtij vendimi.

5-Ky vendim përbën titull ekzekutiv dhe në rast se nuk ekzekutohet vullnetarisht, ekzekutimi i tij bëhet nga shërbimi përbarimor gjyqësor, privat ose shtetëror, sipas kërkesës së palës kreditore.

6-Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë kryer (në ngarkim të paditësit).


7-Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, brenda 15 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

-U shpall në Korçë, sot më datë 29.03.2023.

SEKRETARE
Vitoria HAJCE



GJYOTAR
Seladin PYSQYLI



Shënim: Kjo shpallje do të qëndroje e afishuar në vendet e mësipërme minimalisht 20 (njëzet ditë) nga data e afishimit.

Shpallja do t'iu dërgohet në dy kopje, njëra prej të cilave duhet të përcillet në gjykatë, menjëherë pas afishimit.

Shpallja u publikua sot në datë _____

Për Njesinë Administrative _____

(emër, mbiemër, firmë)